



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 28.02.2019

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË
MARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR
NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN, DHE QEVERISË SË
KONFEDERATËS ZVICERANE, TË PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA
ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM, PËR PROGRAMIN E
ZHVILLIMIT RAJONAL PËR SHQIPËRINË, RATIFIKUAR ME LIGJIN
NR.66/2017”**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 28.02.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr.66/2017”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Edmond Leka.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe përfaqësues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji *“Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr.66/2017”*, vjen si nevojë e amendimit të tekstit të marrëveshjes së bashkëpunimit teknik për programin e zhvillimit rajonal, ratifikuar me ligjin nr.66/2017, datë 20.4.2017. Marrëveshja e grantit e ratifikuar në vitin 2017, synon realizimin e objektivave të mëposhtme:

- forcimin e sistemeve institucionale të agjencive të zhvillimit, që do krijohen gjatë vitit të tyre të parë të funksionimit (ngritja e kapaciteteve, ngritja e institucioneve, qasjet nëpërmjet pjesëmarrjes);
- hartimi i programeve operacionale të zhvillimit rajonal;
- sigurimi i një qasjeje partneriteti, duke integruar qeverinë vendore, shoqërinë civile, sektorin privat në programimin, monitorimin dhe projektet e zhvillimit rajonal.

Programi për Zhvillimin Rajonal 3 që nisi më 1.4.2017, është duke u zbatuar në kuadër të reformës së zhvillimit rajonal, të ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare që prej vitit 2014. Marrëveshja ndryshuese e paraqitur për ratifikim në Kuvendin e Shqipërisë synon:

1. Përcaktimin e autoritetit bashkëpunues të programit. Marrëveshja aktuale e bashkëpunimit, parashikonte Ministrinë e Zhvillimit Urban, si agjencinë bashkëpunëtoresh të projektit dhe partner zbatues ECORYS dhe Co-PLAN. Në këtë aspekt marrëveshja ndryshuese parashikon që drejtimi i projektit të kryhet nga Zëvendëskryeministri për aspektet e lidhura me legjislacionin, politikën kombëtare për zhvillim dhe programimin kombëtar. Gjithashtu, në kuadër të vënies në funksion të plotë të skemës institucionale të mekanizmit të zhvillimit rajonal, duke marrë në konsideratë se roli i agjencive të zhvillimit rajonal i është transferuar Fondit Shqiptar të Zhvillimit, propozohet që ky i fundit të jetë në rolin e agjencisë bashkëpunuese të projektit.
2. Zgjatjen e afatit të zbatimit të projektit, deri më 31.3.2019. Kjo zgjatje propozohet nga partnerët ndërkombëtarë, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), bazuar në vendimin e Komitetit Drejtues të RDP3, dhe konsiderohet një afat real, bazuar në rezultatet e deritanishme dhe ato të pritshme.

Marrëveshja ndryshuese parashikohet të hyjë në fuqi pas përfundimit të procedurës së brendshme ligjore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

III. ÇËSHTJET TË DISKTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, anëtarët e komisionit kërkuar informacionin lidhur me afatin e përcaktuar për përfundimin e marrëveshjes së bashkëpunimit teknik, i cili

propozohet të jetë data 31 Mars 2019. Përfaqësuesit e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, i cili do të jetë në rolin e Agjencisë Bashkëpunuese të Projektit, sqaruan anëtarët e Komisionit se procesi i zbatimit të kësaj marrëveshje po ndiqet pa ndërprerje dhe afati i përcaktuar në marrëveshjen e nënshkruar nga palët vlerësohet i mjaftueshëm për përmbushjen e objektivave të këtij projekti.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

KRYETARI

EDMOND LEKA

ULSI MANJA